



# Mirë se vini në mësimin parashkollor

Informacione prindërve  
për mësimin parashkollor

# Mësimi parashkollor dhe fillimi i tij

## Viti parashkollor i fëmijës së juaj fillon në vjeshtën 2022

Fëmija i juaj merr pjesë në mësimin parashkollor një vit para fillimit të arsimimit të obliguar, zakonisht atë vit kur fëmija mbushë moshën gjashtë vjeçe.

Në Kaarina mësimi parashkollor organizohet në kujdeset ditore komunale dhe private. [Këtu](#) gjeni njësitë e mësimin parashkollor.

## Regjistrimi në parashkollor

- lajmëroni fëmijën në mësim falas parashkollor deri me 11.2.2022 përmes shërbimeve elektronike
- vendimet për vendet bëhen deri me 10.3.2022

[eShërbimet në Kaarina](#)

## Edukimi i hershëm plotëson parashkolloren

Edukim të hershëm plotësues ipet në lokalet e parashkollorës në mëngjes para se të fillon mësimi parashkollor dhe pasdite pas përfundimit të mësimin parashkollor. Stafi mbetet i njëjtë gjatë asaj dite.

- Kërkoni sipas nevojës edukim plotësues të hershëm deri me datën 11.2.2022
- vendimet për vendet bëhen deri me 10.3.2022

[eShërbimet në Kaarina](#)

Pagesa e edukimit të hershëm përcaktohet në bazë të orëve. Informacione tjera për numrin e orëve dhe pagesat:

[Pagesat e edukimit të hershëm në Kaarina](#)



**Mësim parashkollor ipet katër (4) orë** në ditë kryesisht gjatë orarit të punës së shkollave. Koha e mësimit parashkollor mund të ndryshon nëpër njësi por është paradite.

**Viti parashkollor është i obligueshëm për fëmijën.** Për rritjen, zhvillimin dhe mësimin e fëmijës është me rëndësi që të merr pjesë rregullisht në mësimin parashkollor. Pjesëmarrja e rregullt mbështetë grupin parashkollor dhe zhvillimin e aftësive sociale.

**Për mungesat eventuale të fëmijës** duhet paraprakisht të lajmëroni grupin e mësimit parashkollor. Për mungesa akute, për shembull në rast të sëmundjes, lajmëroni pa vonuar grupin e mësimit parashkollor.

**Mësimi parashkollor është falas** dhe materialet e duhura gjinden në parashkollore.

# Viti parashkollor

**Nëse fëmija merr pjesë vetëm në mësimin parashkollor,** mund të ecë rrugën vetëm deri në parashkollore nëse shtegu është i sigurt. Atëherë **udhëtimi deri në parashkollore** është përgjegjësi e prindërve.

**Fëmija juaj ka të drejtë në transport shkollor falas kur merr pjesë vetëm në mësimin parashkollor dhe**

- rruga e ecur në këmbë është mbi 5 kilometra

OSE

- kur mirren parasyshë mosha e fëmijës apo kushtet tjera, udhëtimi është tepër i vështirë, i rëndë ose i rrezikshëm

OSE

- fëmija është në kujdes ditor familjar në edukim të hershëm plotësues

[Informacione tjera për transportin shkollor dhe dorëzimin e aplikacionit për transport shkollor](#)

# Viti parashkollor

**Nëse fëmija juaj ka dietë të veçantë** apo nevoja tjera të veçanta lidhur me ushqim, i sjellni drejtorit të qerdhes të dhënat e dietës së veçantë dhe vërtetimin e mjekut.

**Këmbimi i mesazheve mes shtëpisë dhe parashkollores** bëhet në Wilma. Poashtu, në Wilma gjindet edhe planprogrami i mësimit parashkollor. Dokumentet e mësimit të fëmijës dhe përkrahjes që merr transferohen automatikisht te mësimi parashkollor në Kaarina.

Gjatë vitit parashkollor **bashkëpunojmë me shkollën e afërt.**

## Orari i punës dhe pushimeve 2022-2023

Në kohërat e pushimeve më poshtë veprimtaria e edukimit të hershëm përqëndrohet në qerdhet kujdestare.

### Semestri vjeshtor 10.8. - 21.12.2022

Pushimet:

- Pushimi vjeshtor 17. - 21.10.2022
- Pushimi dimror 22.12.2022 - 8.1.2023

### Semestri pranveror 10.1. - 31.5.2023

Pushimet:

- Pushimi i skijimit 20. - 24.2.2023

# Planprogrami i mësimit parashkollor

”Ilo kasvaa yhdessä toimien”

## Kaarinan kaupungin esiopetussuunnitelma 2016



kansikuva: Maija Elmnäinen

Në vjeshtë secilit fëmijë i bëhet plani personal i mësimit parashkollor së bashku me mësuesen e parashkollores, fëmijën dhe prindërin.

Plani vlerësohet në konfigurim të njejtë në Janar-Shkurt si dhe në pranverë para përfundimit të mësimit parashkollor.

Prindërit vazhdimisht mund ta shiqojnë planin në Wilma.

# Gëzimi rritet në bashkëveprim

## Tërsitë mësimore të parashkollorës

- Format e shumta të të shprehurit
- Bota e pasur e gjuhës
- Unë dhe ambienti jonë
- Hulumtoj dhe veproj në ambientin tim
- Rritem dhe zhvillohem

## Njohuri të shumëllojshme në mësimin parashkollor

- Të menduarit dhe të mësuarit
- Njohuria kulturore, bashkëveprimi dhe të shprehurit
- Kujdesi për veten dhe aftësitë ditore
- Shkrim-leximi
- Njohuritë kompjuterike dhe të teknologjisë së informatikës
- Pjesëmarrja dhe ndikimi



Aftësitë për të jetuar

## Përkrahje rritjes dhe mësimit në arsimin parashkollor

Fëmijët që janë në mësimin parashkollor sipas ligjit mbi arsimin fillor bëjnë pjesën e rrethit të përkrahur të rritjes dhe mësimit. Sipas ligjit fëmija ka të drejtë të merr përkrahje dhe udhëzime të mjaftueshme në mësim po sa të lajmërohet nevoja për përkrahje. Përkrahja i ipet fëmijës në grupin e vet parashkollor. Tre nivelet e përkrahjes së rritjes dhe mësimit të fëmijës janë ndihma e përgjithshme, ajo e intensifikuar dhe ndihma speciale. Fëmija merr ndihmën në rend të parë në grupin e vet parashkollor me metodat e ndryshme dhe ato pedagogjike.

# Përkrahje dhe ndihmë gjatë vitit parashkollor

## Kujdesi për nxënësit e parashkollorës

Kujdesi për nxënësit e parashkollorës përbëhet nga grupi punues multiekspert ku bëjnë pjesë psikologu dhe punonjësi social i shkollës si dhe shërbimet shëndetsore. Shërbimet shëndetsore për fëmijët e parashkollorës ipen në këshilltore.



Këtu gjeni informacione tjera për mësimin special në arsimin parashkollor në Kaarina

Vendi më  
i mirë për  
tu rritur.

Mirë u fafshim në  
mësimin parashkollor  
të mërkuren

10.8.2022

